

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mejdini: Biznesmeni tek i cili dyshohet se spiunoi Hyseni shihet si “këshilltar në hije” i Edi Ramës
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/mejdini-biznesmeni-tek-i-cili-dyshohet-se-spiunoi-hyseni-shi-het-si-keshilltar-ne-hije-i-edi-rames
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 00:55:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 16:04:47 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d67d701e0eecf97b401a304fd080dc1115b7634d8b518af457ca6b47bc769ec2
TEKSTI	849aa34edeb23b71043e957efc4ce56b30c9dbf7b7be63b7f1059c9e7e34ec95
PAMJA	c86a84281213fc4c5faff8e87a44966f461d4208c5a1527e068264f8b2955468

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	23b9f21c89c4d4eb0e7fa3f273f6c9267d55d500a363a35953568c532a383770
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dda7d23b558402c926cd6fed567bb6eba8126329f8a189914308aeb661b57cd2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/23b9f21c89c4d4eb0e7fa3f273f6c9267d55d500a363a35953568c532a383770>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


Mbështetje KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

ARBËRI

Mejdini: Biznesmeni tek i cili dyshohet se spiunoi Hyseni shihet si “këshilltar në hije” i Edi Ramës



23 shtator 2026 18:04

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalim tonë zyrtar në Viber

Gazetarja Fatjon Mejdini nga Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar, ka thënë se i akuzuari për krijimin e një grupi të strukturuar kriminal me qëllim manipulimin e tenderëve të Agjencisë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit (AKSHI), Ergys Agasi, me të cilin tanimë ish-shefja e Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH), Vlora Hyseni, dyshohet se ka pasur një lidhje dhe i ka përcjell sekrete shtetërore, është njeri i afërt me kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama.

Hyseni të martën është shkarkuar nga pozita drejtuese në SHISH-it nga kryeministri Rama, pasi që Gjykata e Posaçme aprovoi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme ajo të pezullohet nga detyra dhe të vendoset në arrest shtëpiak, nën dyshime për dy vepra penale, “Përkrahja e autorit të krimit” dhe “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”.

Mejdini në një intervistë në emisionin “60 Minuta” në KTV, ka thënë se Hyseni dyshohet se ka pasur lidhje intime me Agasin.

Ajo ka thënë se Prokuroria pretendon se Agasi ishte një person që kishte autoritet shumë të madh mes institucioneve dhe ishte një lloj ndërlidhësi në mes të pjesës institucionale dhe pjesës së krimit të organizuar

“Ai ishte një person që qarkullonte lirish në mes të asaj që është bota legale dhe asaj që është bota ilegale dhe sigurisht mendohet se ai mbante lidhje edhe me krimin e organizuar. Zyrtarisht ai është një biznesmen por Prokuroria dyshon se ai ka lidhje me krimin e organizuar. Akuzat zyrtare për të cilat ai akuzohet janë manipulim i tenderëve dhe për një grup të organizuar kriminal në kuptim të manipulimit të rezultateve të tenderëve shtetërorë”, ka thënë Mejdini.

Ajo ka thënë se Agasi ishte si një këshilltar në hije i kryeministrit Rama.

“Ergys Agasi ka qenë pjesë e administratës në Shqipëri, e ka nisur me Lëvizjen Socialiste për Integritet të Ilir Metës dhe pastaj është pozicionuar dukshëm me Partinë Socialiste të Shqipërisë. Opozita dhe unë mendoj edhe logjika e thotë që ia ka qenë një

Arbëri.

Vuçiqi në Asambleenë e OKB-së falënderon shtetet që s’e kanë njohur Kosovën

Arbëri.

Vela e cilëson gjysmak vendimin e Gjykatës Kushtetuese

Kulturë.

“Valle tradicionale të Opojës” në hap të ruajtjes së thesareve popullore

Showbiz.

Harvey Weinstein dënohet me 15 vjet burgim për sulm seksual

Basketboll.

Peja mposhtet thellë, kualifikimi thuajse i pamundur

Botë.

Zelensky në OKB: Putini është “pacienti zero”, prej të cilit lufta vazhdon të përhapet

njeri shumë i atërt me kryeministrin Rama, ka shumë diskutime se nga i buronte Agasi gjithë kjo fuqi për të pasur këtë lloj ndikimi në institucionet shtetërore dhe duket se kjo fuqi vinte nga vetë kryeministri Edi Rama. Ai është konsideruar nga ish-bashkëpunëtorë të kryeministrit po kështu edhe nga opozita si një këshilltar në hije i kryeministrit Rama”, ka thënë Mejdini.

Edhe



Arbëri • 12 n. më parë
Rama emëron u.d. të shefit të SHISH-it pas shkarkimit të Vlora Hysenit

Hyseni e kishte marrë detyrën e shefes së SHISH-it në prill të vitit 2023, dy vjet pasi kishte punuar si këshilltare për çështje të sigurisë te kryeministri Edi Rama.

Para këtyre emërimeve, ka pasur karrierë të gjatë në strukturat e sigurisë kombëtare në Kosovë.

Hyseni ka qenë zëvendës drejtoreshë e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë nga shkurti i vitit 2019. Ndërkaq, në krye të institucionit më të lartë të sigurisë dhe inteligjencës së Kosovës është vënë që nga dhjetori i vitit 2020 kur ishte shkarkuar drejtori Kreshnik Gashi, deri në prillin e vitit 2021, kur në detyrën e drejtorit u emërua Petrit Ajet. Ajo ishte shkarkuar nga posti i zëvendës drejtoreshës në qershorin e vitit 2021 nga presidentja e atëhershme Vjosa Osmani e kryeministri Albin Kurti, të cilët asnjëherë nuk kanë dhënë sqarime për arsyet e këtij vendimi.

#FATJONA MEJDINI

#VLORA HYSENI

#BERGYS AGASI

#SHISH

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 22 sht 2026
Vlora Hyseni u dorëzohet autoriteteve shqiptare në Vërmicë



Arbëri • 22 sht 2026
Rama e liron nga detyra shefen e SHISH-it, Vlora Hyseni



Arbëri • 22 sht 2026
Arrest shtëpiak për drejtoreshën e SHISH-it në Shqipëri, në Kosovë qe shkarkuar nga AKI-ja



Arbëri • 7 sht 2026
Bytyqi: Provat e Prokurorisë në rastin e Shehollit janë serioze, pres që të vërtetohen

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkohësi i përmblajtyeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.